

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2010

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E martë, 1 qershor 2010

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme artistike; koreografike; sportive; me kohë të shkurtuar

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9a	9b	10	11a	11b	11c
Pikët														
Kërkesa	12a	12b	13a	13b	13c	13d	14	15	16	17	18	19	20	21
Pikët														
Kërkesa	22a	22b	22c	23	24a	24b	25							
Pikët														

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****DRITËRO AGOLLI****Enigma e maleve**

Enigma në male përgjon në qoshe dhe skuta:

Ti s' di pse rrinë në heshtje dy driza,

Se ç' bëjnë nën gur dy hardhuca;

S' kupton pse hidhen dy ketra në pisha;

S' merr vesh se ç' flitet në kulla,

Ç' i thonë në shteg njëri-tjetrit dy njerëz,

Se ç' pëshpërisin tri çupa ku ndahet udha,

Se ç' fshehin në torba dy djem leckamanë të vegjël;

Se ç' ndodh në përrenjtë e thellë:

Kush hyn e del si vjedhës me shpinë kërrusur,

Kush rrëkëllen një gur nga një shpellë

Dhe kush ulërin nga dhimbja mes mjegullit futur.

Kurrkush s' e kupton enigmën e malit,

Komplotin e tij të fshehtë e ka frikë,

Rrëqethet kur ecën pas zallit

Tek kokën ngre në shpatet hanxharë e thikë.

Për pyetjet nga 1 deri në 7 rrethoni alternativën e saktë.

1. Poezia “Enigma e maleve” është lirikë: **1 pikë**
  - A) peizazhi
  - B) meditative
  - C) elegjiake
  - D) erotike
  
2. Motivi kryesor i kësaj poezie është i lidhur me: **1 pikë**
  - A) tokën
  - B) familjen
  - C) atdheun
  - D) malin
  
3. Agolli e kërkon përsosmërinë poetike te kjo poezi në: **1 pikë**
  - A) përzgjedhjen tematike
  - B) shprehjen e botës shpirtërore të heroit
  - C) elemente të subjektit
  - D) elemente të metrikës
  
4. Poeti nuk krijon distancë me lexuesin, sepse ndjenja e tij: **1 pikë**
  - A) ka përmasë universale
  - B) bie ndesh me natyrën njerëzore
  - C) krijon raporte inferioriteti me lexuesin
  - D) është në luftë të përhershme me arsyen
  
5. Në vargun “Enigma në male përgjon në qoshe dhe skuta” është përdorur figura e: **1 pikë**
  - A) simbolit
  - B) metaforës
  - C) krahasimit
  - D) epitetit
  
6. Cila është pjesa e ligjëratës që përdoret më shumë në fund të vargjeve të kësaj poezie? **1 pikë**
  - A) folja
  - B) ndajfolja
  - C) emri
  - D) mbiemri
  
7. Atmosferën e veçantë, titullit të kësaj poezie, ia jep: **1 pikë**
  - A) grupi emëror i vetë titullit
  - B) rasa gjinore e fjalës mal
  - C) zgjedhja e malit si objekt referimi
  - D) raporti njeri-mal

8. Gjeni në strofën e fundit foljen, që tregon se përballja me enigmën është e frikshme. **1 pikë**

\_\_\_\_\_

9. Sillni shembuj që dëshmojnë frymëzimin e poezisë së Agollit nga jeta e përditshme dhe krijimtaria popullore (nga një shembull për secilin rast). Ç' tipar fiton poezia e tij nga ky frymëzim?

a) nga jeta: \_\_\_\_\_ **2 pikë**

nga krijimtaria popullore: \_\_\_\_\_

b) tipari që i japin poezisë këto shembuj: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

10. Ç' efekt stilistik përftohet nga përdorimi i përemrit të pacaktuar *kurrkush*?

Si e shihni raportin e këtij efekti me enigmën, përjashtues apo përfshirës? A ndihmon fjala *kurrkush* në zbulimin e këtij raporti? **3 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

11. Ndiqni me vëmendje rrugëtimin e enigmës në poezinë e Agollit.

a) Ku e ndesh fillimisht poeti enigmën? \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Përshkruani ku ndeshet enigma më pas deri në fund të poezisë. **1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

c) Pse autori që në titull fjalën *mal* e ka përdorur në numrin shumë? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

12. Shpirtëzimi dhe misteri janë dy tipare të malit në këtë poezi. Interpretoni marrëdhënien e veçantë midis këtyre dy tipareve dhe malit. Ilustrojeni me nga një shembull për secilin tipar.

a) interpretimi: \_\_\_\_\_ **2 pikë**

\_\_\_\_\_

b) shembulli i shpirtëzimit: \_\_\_\_\_ **2 pikë**

shembulli i misterit: \_\_\_\_\_



**PJESA II****ERNEST HEMINGUEJ****Plaku dhe deti (fragment)**

Mendja iu turbullua përsëri, por fillin me peshkun e madh e tërhiqte me gjithë fuqinë. “Ja dola ta ktheja - anash, - mendoj ai. - Këtë herë mund ta kthej me bark.” - Tërhiqeni! - urdhëroi duart. - Qëndroni fort, këmbë!

Kthjellohu, mendje! Ti kurrë s’më ke lënë në baltë. Në çastin që peshku u gjend fare pranë varkës, plaku e tërhoqi me sa fuqi kishte. Por peshku vetëm sa u kthye pak anash, pastaj drejtoi trupin dhe notoi tej.

- Dëgjo, peshk! - i foli plaku. - Ti për të ngordhur ke, pse kërkon që të vdes dhe unë?

“Kështu nuk bëj dot gjë, - mendoj. Goja iu tha aq shumë, sa nuk mund të nxirrte një fjalë, por s’kishte fuqi as të shkonte deri te paguri i ujit, që ndodhej dy hapa larg.

- Këtë radhë duhet ta tërheq pranë varkës. Nuk mund të rezistoj dot shumë; Jo, mund të rezistoj, - kundërshtoi në çast veten. - Ti, plak, gjithnjë reziston.”

- Ti do që të më vrasësh, peshk, - tha plaku. - Sigurisht, është e drejta jote. Asnjëherë në jetë s’kam parë qenie më gjigante, më të mrekullueshme, më të qetë e më fisnike se ti. Hë, ç’pret? Vritmë! S’dua t’ia di se cili më vret.

“Përsëri po të turbullohet mendja, plak! Por atë duhet ta kesh të freskët. Mblidh mendjen dhe mundohu të durosh vuajtjet, si njeri i vërtetë... Ose si peshk, -shtoi ai me vete.”

“Ç’të bëj? - vrau mendjen plaku. Sa herë që peshku largohej, atij i bëhej sikur do t’i binte të fikët. - Ç’të bëj? Do ta provoj edhe një herë.”

“Do ta provoj përsëri”, - tha plaku me vete, megjithëse duart iu prenë fare dhe para syve iu bë mjegull.

Provoi përsëri dhe peshku përsëri u largua. “Ah! - i shpëtoi një thirrje dhe në çast ndjeu se brenda tij jeta po shuhej. - Do ta provoj dhe një herë.”

Mblodhi tërë fuqinë e mbetur, gjithë krenarinë e humbur me kohë dhe i hodhi në duel me peshkun. Plaku lëshoi fillin në dyshemenë e varkës, e mbajti me këmbë, ngriti fuzhnjën lart aq sa mundi dhe me tërë fuqinë që i kishte mbetur e që mundi të mblidhte atë çast, e goditi peshkun pas pendës së madhe të gjoksit, e cila i kishte dalë mbi ujë. Ndjeu si u fut maja e hekurit në mish, ndërsa ai shtynte fuzhnjën thellë e, më thellë me tërë peshën e trupit. Atëherë peshku u përpëliti, e megjithëse mbante brenda vetes vdekjen, u ngriti lart mbi ujë, sikur me trupin e tij gjigant, me bukurinë e fuqinë e tij donte të krenohej...

“Ç’po ndodh kështu me kokën time vallë? - tha plaku, duke ngjeshur fytyrën pas dërrasës së bashit. - Jam plak dhe u lodha shumë. Megjithatë, e vrava këtë peshk, që e kam më të shtrenjtë se vëllanë. Duhet të bëj gati gjithçka që më nevojitet, pastaj ta lidh fort peshkun pas varkës, të ngre valën dhe të kthehem në shtëpi”.

Për pyetjet nga 14 deri në 19 rrethoni alternativën e saktë.

14. Heminguej bën pjesë në grupin e shkrimtarëve të: **1 pikë**
- A) romantizmit
  - B) brezit të humbur
  - C) realizmit magjik
  - D) sentimentalizmit
15. Tema kryesore e këtij fragmenti është: **1 pikë**
- A) lufta për ekzistencë
  - B) frika nga peshku
  - C) enigma e vdekjes
  - D) bukuritë e detit
16. Fjalët e plakut, kur ai i drejtohet vetes në vetën e dytë: “Qëndroni fort, këmbë,” japin: **1 pikë**
- A) monologun me zë të lartë
  - B) figurën e ironisë
  - C) motivin e humbjes së shpresës
  - D) mbylljen në vetvete të personazhit
17. Shprehja e përdorur nga plaku në fragment: “...s’më ke lënë në baltë”, është një: **1 pikë**
- A) inversion
  - B) fjalë e urtë
  - C) shprehje frazeologjike
  - D) pyetje retorike
18. Peshkatari mediton për: **1 pikë**
- A) dashurinë e humbur prej vitesh
  - B) misteret e detit pafund
  - C) jetën kur të kthehej sërish në tokë
  - D) qëndresën si sprovë mbijetese
19. Mesazhi që përcillet nga ky fragment është: **1 pikë**
- A) me vështirësitë njeriu nuk ndeshet kurrë
  - B) njeriu nuk duhet të tërhiqet para vështirësive
  - C) vështirësive është më mirë t’u shmangemi
  - D) njeriu duhet të gjendet i vetëm në vështirësi
20. Gjeni në paragrafin e fundit fjalinë ku shfaqet paradoksi, i cili tregon dashurinë e plakut për peshkun, megjithëse ai e vret atë. Si e konsideron plaku peshkun? **2 pikë**
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

21. Peshkatari plak bën qëndresë për dy arsye. Identifikoni këto dy arsye në fragment. **2 pikë**

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

22. Plaku përsërit me vete: “Ç’të bëj? Do ta provoj edhe një herë.”

a) Pse përdoret fjalia pyetëse? \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) Çfarë pohon në fjalinë e dytë në raport me të parën? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

c) Ç’tipar të tijin demonstroi personazhi në këtë rast? **1 pikë**

\_\_\_\_\_

23. Shpjegoni pse plaku luftën për të vvarë peshkun e quan duel. **2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

24. Ndaluni në pjesën e dytë ku plaku e përshkruan peshkun.

a) Ç’përshtypje ju bën përshkrimi që plaku i bën peshkut? **2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

b) Tregoni ç’ pjesë e ligjëratës e ndihmon përshkrimin e autorit. Sillni një shembull.

**2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

25. Shpjegoni një tipar të stilit të Heminguejit që del në këtë fragment.

**2 pikë**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_